



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH .nr.640/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Goran Milenkovic - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “DWH Kosova SH.P.K” - Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje të instrumentit GPS dhe Total Station”, me nr. të prok: 632-20-3153-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë, më datë: 08.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “DWH Kosova SH.P.K” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje të instrumentit GPS dhe Total Station”, me nr. të prok: 632-20-3153-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë.

II. OBLIGOHET, autoriteti kontraktues / Komuna Gjakovë / ti bëjë ndryshimet në dosje të tenderit konform ekspertit teknik dhe të veproj konform nenit 53.7 të LPP-së, lidhur me aktivitetin të prokurimit “Furnizim me pajisje të instrumentit GPS dhe Total Station”, me nr. të prok: 632-20-3153-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “DWH Kosova SH.P.K” - Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE “DWH Kosova SH.P.K” - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 07.09.2020 me nr. 640/20, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje të instrumentit GPS dhe Total Station”, me nr. të prok: 632-20-3153-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 7, 10 dhe nenin 28 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 09.09.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues dhe ekspertin teknik të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues dhe eksperti teknik i prokurimit në raportin e dt: 16.09.2020, lidhur me pretendimin ankimorë të OE-ankues sqaron si në vijim:

Në lidhje me pretendimin për sistemin operativ “Windows” dhe “Memorie”, rikujtojmë se këto çështje janë trajtuar në raportin paraprak dhe vendimin e Panelit Shqyrtues numër 458/20. Eksperti shqyrtues dhe teknik konsiderojnë se ri-shqyrtimi i pretendimit të njëjtë ankimor është në kundërshtim me Rregulloren e Punës së OSHP-së 01/2017, përkatësisht nenin 16, paragrafi 2, dhe në të njëjtën kohë e njofton Panelin Shqyrtues se këto pretendime janë trajtuar, rrjedhimisht qëndrojmë pranë sqarimit të dhënë në raportin paraprak të datës 28.07.2020. Rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

Në lidhje me pretendim për nivelin e IP dhe sinjalet satelitore, ku OE ankues kërkon që të rriten

specifikimet teknike, edhe tani sikurse në raportin paraprak, sqarojmë se AK-të i përcaktojnë kriteret e kualifikimit përkatësisht specifikacionet teknike duke u bazuar në nevojat e tyre për furnizimet apo shërbimet e AK-se, në përputhje me parimet e prokurimit publik drejt qasjes sa më të madhe të zgjerimit të konkurrencës. Andaj, pretendimi këtë pretendim e kualifikojmë si të pabazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e cekura në raport, Eksperti shqyrtues / teknik i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE - "DWH Kosova SH.P.K" - Prishtinë, të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Më tej propozohet që të obligohet AK të bëjë korrigjimet sipas sqarimeve të dhëna më lartë dhe të bëhet zgjatja e afatit për dorëzimin e ofertave konform dispozitave të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues nuk është deklaruar se a pajtohet apo nuk pajtohet me mendimin e ekspertit teknik/shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 17.09.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, duke sqaruar si në vijim:

Ne, jemi njohur sot me raportin e Ekspertit Shqyrtues (me poshtë ESH), dhe jemi surprizuar me këtë raport, i cili - si do shprehemi ne vazhdim - nuk ka as vlerën e letrës në të cilën është shkruar. ESH ka fshirë 60% të Detaleve, Fakteve dhe Argumenteve të dhëna nga OE.

Kjo në gjuhën juridike njihet si "manipulim i fakteve" dhe penalizohet në mënyrë të qartë dhe të prerë nga ligji. Vetëm me këtë fakt - fshirjen e 60% të ankimimit / padisë - e ashtuquajtura ekspertizë e ESH bie tërësisht. Me këtë veprim ESH, jo vetëm ka tjetërsuar subjektin e ankimimit, duke tejkaluar "përshkrimin e punës së vet" (job description), por çuditërisht ka tejkaluar edhe kompetencat e OSHP-së, pasi as OSHP, si edhe asnjë gjykatë tjetër, nuk mund të ndërhyjë në ri-definimin e objektit të ankimimit / padisë. ESH i mungojnë njohuritë elementare në fushën juridike, sepse ai nuk ka mësuar që rolet "pale paditëse" "palë e paditur" "trup gjykues" dhe "ESH" janë qartësisht të mirëdefinuar nga ligji, si dhe kompetencat respektive. Kush merr përsipër të definojë dhe/ose ridefinojë objektin e ankimimit / padisë, është automatikisht palë ankimuese (paditëse), dhe ESH duke fshirë 60% të objektit ankimues (paditës) është bërë palë paditëse, çka shkarkon automatikisht si ESH. Por duke tejkaluar "job description", ESH ka tejkaluar kompetencat e veta, dhe raporti i dhënë është automatikisht "pa objekt". Konkretisht:

Fakti 1 i ankimimit të OE është fshirë. Ky nga ligji konsiderohet MANIPULIM dhe është i dënueshëm
Fakti 4 i ankimimit të OE është fshirë. Ky nga ligja konsiderohet MANIPULIM dhe është i dënueshëm

Fakti 5 i ankimimit të OE është fshirë. Ky nga ligja konsiderohet MANIPULIM dhe është i dënueshëm

Fakti 2 i ankimimit të OE, i cili është pika 1 në raportin e ESH 640/20.

ESH ka vënë re që OSHP me vendim 458/20 e detyron AK që sistemin operativ të kërkuar nga AK (windows) t'a zgjerojë me sisteme operative EKUIVALENTE (android, IOS etj), por AK aplikon një logjikë hileqare, ku vendos në vend të windows, versione të ndryshme të windows (10, 7 dhe 8), duke krijuar iluzionin e ekuivalencës. Pra AK të njëjtin sistem operativ (windows) e konsideron alternativ me vetveten. ESH as që ka kuptuar gjë fare. Në vend që të evidentojë qartë para OSHP, që Vendimi 458/20 i OSHP edhe pse nuk është ankimuar në Gjykatë Themelore, nuk është respektuar nga AK, por me një trik hileqar, kërkon t'i bishtoj vendimit 458/20. Në vend që të infirmojë OSHP për mosrespektimin e vendimit 458/20 nga AK, dhe t'i propozojë penaltetin që parasheh ligji, e kalon këtë shkelje të rënde të ligjit, me sportivitet. Përse? Sepse nuk ka kapacitetin e duhur për detyrën që i është ngarkuar.

Fakti 3 i ankimimit të OE, i cili është pika 2 në raportin e ESH 640/20.

AK kërkon IP68 për kontrollerin (pjesë periferike, pa influencë në saktësinë dhe sigurinë e matjeve).

Por për GPS, që është vetë instrumenti, AK as që kërkon IP fare.

Perse AK kërkon IP për pjesën periferike pa influence në matje, dhe nuk kërkon IP për instrumentin (GPS) me influencë tërësore dhe absolute në matje? Përgjigja: Sepse kërkon të manipulojë tenderin. AK kërkon memorie 64GB, por nuk shprehet e brendshme apo e jashtme (mungesë totale transparencë). Përse AK nuk shprehet nëse memoria 64GB është e jashtme apo e brendshme? Përgjigja: sepse kërkon të manipulojë tenderin (duke na surprizuar pas ofertave, që kërkohet e brendshme). AK na ka vënë 6 burime, tek të cilat AK është bazuar për përcaktimin e specifikimeve teknike të kontrollorit. Këto 6 burime përmbajnë 17 kontrollera në total. Nga këto 17 kontrollera vetëm 1 i plotëson kërkesat e AK (????!!), 16 të tjerë nuk i plotësojnë. Ne i kemi vendosur AK dhe OSHP dhe ESH edhe linqet respektive të burimeve të dhënë nga AK. Përse AK bazohet në 1 produkt dhe injoron, i përjashton tërë produktet e tjera? Përgjigja: sepse kërkon të manipulojë tenderin. A e lejon ligji të bazohet në një produkt të vetëm? Përgjigja: Jo.

Po si ka mundësi që ESH nuk i ka verifikuar këto, dhe i jep pa përgjegjësi të drejtë AK? Përgjigja: Sepse nuk ka kapacitetin e nevojshëm profesional dhe faktet tona as që i ka kuptuar fare, i janë dukur si gjuhë kineze. Ne kemi bindjen, që ky ESH nuk duhet të këtë marrë as edhe një leksion në lëmin e gjeodezisë. Ky rast shprehur në mënyrë figurative është "si të konsiderosh berberin kirurg".

Konkluzione:

1. Ne kontestojmë ekspertizën 640/20, e cila bazohet në një manipulim dhe falsifikim paraprak të ankimimit tonë, dhe si rrjedhojë paraqet ankimimin tonë para OSHP të manipuluar dhe

falsifikuar. Një ekspertizë që bazohet në një material të manipuluar dhe falsifikuar, nuk mundet vetëm se të prodhojë një ekspertizë të manipuluar dhe falsifikuar.

2. Ne kërkojmë që Ekspertiza të ri-bëhet nga një ESH që ka kapacitetin e nevojshëm profesional, si dhe dinjitetin e duhur profesional.

3. ESH i ekspertizës së përsëritur duhet të marrë kontakt me të dyja palët dhe jo vetëm me AK, por edhe me OE.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 08.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për kontratës.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se për sistemin operativ “Windows” dhe “Memorie”, paneli shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se këto çështje janë trajtuar në raportin paraprak dhe vendimin e Panelit Shqyrtues numër 458/20, andaj ri-shqyrtimi i pretendimit të njëjtë ankimor është në kundërshtim me Rregulloren e Punës së OSHP-së 01/2017, përkatësisht nenin 16, paragrafi 2.

Lidhur me pretendimin e ankuesit për nivelin e IP dhe sinjalet satelitore, ku OE ankues kërkon që të rriten specifikimet teknike. Paneli shqyrtues konform ekspertit teknik konstaton, se, sqarojmë se AK-të i përcaktojnë kriteret e kualifikimit përkatësisht specifikacionet teknike duke u bazuar në nevojat e tyre për furnizimet apo shërbimet e AK-se, në përputhje me parimet e prokurimit publik drejt qasjes sa më të madhe të zgjerimit të konkurrencës. Andaj, pretendimi këtë pretendim e kualifikojmë si të pabazuar.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në sqarimet e cekura në raport, konstaton se ankesa e OE - “DWH Kosova SH.P.K” - Prishtinë, aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe obligohet AK të bëjë korrigjimet sipas sqarimeve të dhëna nga an e ekspertit teknik.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna e Gjakovës

1x1 OE –“DWH Kosova SH.P.K.”-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.